Pyetje që shtrohen shpesh mbi tuberkulozin dhe përgjigjet e tyre.

1. Çfarë është tuberkulozi?
Tuberkulozi është një sëmundje infektive që shkaktohet nga bakteret e tuberkulozit *(Mycobacterium tuberculosis)*. Forma më e përhapur është tuberkulozi i mushkërive (rreth 70%). Forma të tjera si p.sh. tuberkulozi i gjëndrave limfatike ose i kockave nuk janë ngjitëse.

2. Çfarë është një infeksion latent tuberkulozi?
Një infeksion latent tuberkulozi do të thotë, që një person dikur në jetën e tij ka pasur kontakt me bakterie tuberkulozi dhe në këtë mënyrë i është ngjitur (infektuar). Në këtë etapë personi nuk është as i sëmurë dhe as përhapës sëmundje. Shumica e personave të infektuar (rreth 90%) nuk sëmuren kurrë me tuberkuloz.

3. Si përhapet tuberkulozi?
Transmetimi i bakterieve të tuberkulozit realizohet nëpërmjet ajrit nga njeriu tek njeriu. Personi i sëmurë gjatë kollitjes nxjerr pikëza të vogla mikroskopike me bakterie tuberkulozi në ajër. Ato fluturojnë për një kohë të caktuar në ajër dhe mund të thithen nëpërmjet frymëmarrjes nga persona të tjerë. Rreziku i ngjitjes së sëmundjes (infektimit) ekziston vetëm nëse keni kontakt me një person me tuberkuloz mushkërish ngjitës. (Pyetja 6).

4. Kur flitet për një sëmundje tuberkulozi?
Mbi një sëmundje tuberkulozi flitet nëse bakteriet në mushkëri shumohen. Kjo mund të ndodhë pas disa muajve ose viteve pas infektimit. Nëpërmjet rrugëve të gjakut bakteriet e tuberkulozit mund të përhapen edhe në pjesën tjetër të trupit (p.sh. gjëndrat limfatike, sistemi qendror i nervave, kocka). Këto forma të tuberkulozit nuk janë ngjitëse. Tuberkulozi është i rrezikshëm sidomos për fëmijë të vegjël dhe persona me imunitet të dobësuar. Sot tuberkulozi është i shërueshëm, nëse trajtohet drejtë.

5. Cila janë simptomat tipike të një sëmundje me tuberkuloz?
Shpesh sëmundja fillon me pak ankime. Ndër to përkasin: Kolla (nganjëherë me sekrecione me gjak),rënie peshe, anoreksi, lodhje, ethe të lehta, djersitje natën, dhimbje në gjoks.

6. Kur flitet për një tuberkuloz mushkërie ngjitës?
Për një tuberkuloz ngjitës mushkërie, nëse sëmundja e mushkërisë ka përparuar aq shumë sa personi i sëmurë nxjerr gjatë kollitjes (si dhe teshtitjes) bakterie tuberkulozi. Vetëm në këtë fazë të sëmundjes personi i sëmurë mund të transmetojë tuberkulozin dhe të infektojë njerëz të tjerë (Pyetja 3).

7. Për sa kohë qëndron një person i injektuar me tuberkuloz mushkërish ngjitës?
Një person me tuberkuloz ngjitës mushkërish izolohet në spital ose në shtëpi, kjo do të thotë që ai izolohet nga ambientit i tij. Ai qëndron për aq kohë i izoluar, deri sa sëmundja të mos jetë më ngjitëse. Normalisht një gjë e tillë zgjat dy deri në tre javë. Më pas sëmundja nuk është më ngjitëse. Por sëmundja duhet të vazhdojë terapinë nën kontrollin e mjekut gjithsej gjashtë muaj ose më gjatë deri në shërimin e plotë.

8. Kush rrezikon të infektohet?
Një rrezik infektimi kanë vetëm personat, që kanë pasur kontakt tepër të ngushtë (për shumë orë në të njëjtat ambiente) me një njeri të sëmurë me tuberkuloz ngjitës të mushkërive (Pyetja 6).

SWISS LUNG ASSOCIATION

9. Unë jam vaksinuar. A mundem unë përsëri të infektohem?

Po, pasi vaksinimet e kryera rregullisht më parë kundër tuberkulozit (BCG) ofrojnë vetëm një mbrojtje të kufizuar.

10. Unë kisha kontakt me një person të sëmurë me tuberkuloz mushkërish, çfarë duhet të bëj?

Qendra e specializuar e tuberkulozit e ligës kantonale të mushkërisë të kantonit tuaj ofron këshilla falas dhe Informacione mbi të gjitha pyetjet për tuberkulozin. Kush ka pasur kontakt të afërt me një person të sëmurë me tuberkuloz ngjitës të mushkërive (Pyetja 6), mund të lërë një takim me qendrën e specializuar për tuberkulozin (adresat janë në shtojcë), për tu informuar dhe për tu testuar, nëse është infektuar (Pyetja 12).

11. Un kisha kontakt me një person, që është i sëmur me një tuberkuloz jashtë mushkërisë, çfarë duhet të bëj?

Ju nuk duhet të bëni asgjë, pasi nuk ekziston rrezik. Forma të tilla tuberkulozi nuk janë ngjitëse, pasi nga personat e sëmurë nuk nxirren bakterie tuberkulozi nga rrugët e frymëmarrjes.

12. Si mund të vërtetohet një infektim?

Një infektim mund të vërtetohet me një test tuberkulozi në lëkure ose me një analizë gjaku (i quajtur ndryshe edhe testi Gamma-Interferon). Informacione mbi mënyrën e analizave dhe interpretimin e rezultateve të analizave mund të merrni në qendrën e specializuar të tuberkulozit të ligës suaj kantonale të mushkërisë.

13. Përse bëhet testi i tuberkulozit në lëkurë dhe/ose analiza e gjakut tek personat që janë më të mëdhenj se 12 vjeç vetëm pas tetë javësh pas kontaktit të fundit me një person të sëmurë me tuberkuloz ngjitës mushkërie?

Bakteriet e tuberkulozit shumohen shumë ngadalë dhe zhvillimi i një reagimi imunolog zgjat disa javë. Nëse ka ndodhur një infektim, mund të vërtetohet vetëm pas tetë javëve. Tek fëmijët poshtë 12 vjeç rreziku është më i madh, që të zhvillojnë forma të rrezikshme të tuberkulozit. Përveç kësaj sëmundja në këtë moshë mund të zhvillohet më shpejt. Për këtë arsye tek ato për arsye sigurie bëhet një test i parë direkt pas kontaktit të fundit dhe – sipas rezultatit të testit – përsëritet përsëri pas tetë javëve.

14. Rezultati i analizës së gjakut është pozitiv. Çfarë do të thotë kjo, dhe çfarë do të ndodhë tani?

Një rezultat pozitiv testi do të thotë, që ka ndodhur një kontakt me bakterie tuberkulozi (Pyetja 2). Qendra e specializuar e tuberkulozit do t'ju informojë Juve dhe mjekun Tuaj , me lutjen, për të vendosur edhe një takim për sqarime të tjera (grafi Röntgen etj.), për të përjashtuar një sëmundje me tuberkuloz.

15. Unë u infektova, a mund të rrezikoj njerëz të tjerë?

Jo! Një infektim nuk do të thotë as që je i sëmurë me tuberkuloz dhe as që mund t'ja ngjitësh të tjerëve (Pyetjet 2, 4 dhe 6). Prandaj me një analizë pozitive gjaku personat tuaj të afërt nuk janë të rrezikuar.

16. Unë u infektova, sa i madh është rreziku që më vonë të sëmurem nga tuberkulozi?

Bakteria izolohet nga sistemi imun. Ajo gjendet në një lloj „gjendje të përgjumur". 90% e të gjithë personave të infektuar nuk zhvillojnë tuberkuloz. 10% zhvillojë një sëmundje tuberkulozi. Nga këto gjysma e tyre zhvillon një sëmundje tuberkulozi brenda 2 vjetëve, pjesa tjetër më vonë në jetën e tyre (Pyetja 4). Rreziku rritet, kur kemi të bëjmë me një mbrojte imune të pamjaftueshme (p. sh. në rast infektimi HIV, trajtime të gjata me kortizon, kemio terapi që suprimon imunitetin, diabet, dhe abuzime me alkolin dhe duhanin).

17. A mund të trajtohem nëse jam infektuar?

Një infektim i vërtetuar (Pyetja 2) trajtohet me antibiotik. Në varësi të antibiotikut kjo zgjat ndërmjet katër dhe nëntë muaj. Trajtimi këshillohet, pasi ajo redukton qartë rrezikun, për të zhvilluar më vonë një sëmundje tuberkulozi. Nëse do të realizohet një trajtim i tillë e vendos personi i infektuar së bashku me mjekun, mjeken që e trajton atë.

SWISS LUNG ASSOCIATION

18. Kush e paguan këtë?

Përballimi i shpenzimeve në lidhje me tuberkulozin është rregulluar ndryshe në çdo kanton. Qendra e specializuar e tuberkulozit e ligës suaj kantonale të mushkërisë ju informon juve me kënaqësi mbi rregullat e vlefshme në kantonin tuaj.

19. A ka përveç qendrave të specializuara të kantoneve për tuberkulozin një vend tjetër në Zvicër për pyetje mbi tuberkulozin?

Po, qendra e kompetencës e tuberkulozit e ligës së mushkërive në Zvicër, e cila kryen detyrat kombëtare me urdhër të zyrës federale për shëndetin. Informacione të mëtejshme gjenden në faqen e internetit www.tbinfo.ch.

20. Si kryhet një analizë e ambientit?

Kur diagnostikohet një tuberkuloz, duhet që mjeku trajtues, mjekja trajtuese dhe laboratori, tia tregojë atë mjekes së kantonit të kantonit ku banon personi i sëmurë. Mjeku i kantonit, mjekja e kantonit vendos bazuar në rezultat e analizave, nëse duhet kryer një analizë e ambientit. Ky është rasti, kur bëhet fjalë për një tuberkuloz mushkërie ngjitës. Nëse ekziston një gjë e tillë, atëherë ngarkohet me detyrë për kryerjen e analizës së ambientit qendra e specializuar e tuberkulozit e ligës përgjegjëse kantonale të mushkërive. Ajo merr kontakt me personin e sëmurë. Së bashku përgatitet një listë e personave të kontaktuar, që kanë një rrezik infektimi (Pyetja 8). Normalisht këto janë pjesëtarë të familjes, partnerët e banimit, kolegë pune ose kohe të lirë.

Më pas informohen këta persona, dhe testohet, nëse ato janë infektuar (pyetja 12).

A e dinit ju që....

…tuberkulozi është një sëmundje infektive, e cila i duhet lajmëruar zyrës federale për shëndetin (BAG)?

…në Zvicër numri i rasteve të reja të tuberkulozit ka shkuar në vitet e fundit ndërmjet 500 dhe 550 në vit?

…që tuberkulozi në Zvicër është i trajtueshëm mirë, nëse ilaçet merren sipas këshillave të ligës së mushkërive Zvicër dhe BAG?

…çdo vit në të gjithë botën (sidomos në vendet në zhvillim) vdesin rreth 1,8 milion njerëz me tuberkuloz?

Competence centre tuberculosis
Südbahnhofstrasse 14c
3000 Berne 14
Phone 031 378 20 50
Fax 031 378 20 51
E-Mail: tbinfo@lungenliga.ch
Internet: www.tbinfo.ch

SWISS LUNG ASSOCIATION

Qendrat e specializuara për tuberkulozin

Aargau/Basel-Land
Lungenliga Aargau
Hintere Bahnhofstrasse 6
Postfach
5001 Aarau
Tel. 062 832 40 00
Fax 062 832 40 01
lungenliga.aargau@llag.ch

Basel Stadt
Kantonsärztlicher Dienst
St. Alban-Vorstadt 12
4001 Basel
Tel. 061 267 95 26
Fax 061 267 95 28
gsd@bs.ch

Bern
Lungenliga Bern
Neubrückstrasse 65
3012 Bern
Tel. 031 300 26 26
Fax 031 300 26 25
info@lungenliga-be.ch

Fribourg
Ligue pulmonaire fribourgeoise
Route des Daillettes 1
Case postale 181
1709 Fribourg
Tel. 026 426 02 70
Fax 026 426 02 88
info@liguepulmonaire-fr.ch

Genève
Ligue pulmonaire genevoise
42-44, avenue Cardinal-Mermillod
1227 Carouge
Tel. 022 309 09 90
Fax 022 309 09 91
info@lpge.ch

Glarus
Lungenliga Glarus
Hauptstrasse 34
8750 Glarus
Tel. 055 640 50 15
Fax 055 640 53 32
lungenligaglarus@bluewin.ch

Graubünden
Lungenliga Graubünden
Gürtelstrasse 80
7000 Chur
Tel. 081 354 91 00
Fax 081 354 91 09
info@llgr.ch

Jura
Ligue pulmonaire jurassienne
Place de l'Eglise 7
2800 Delémont
Tel. 032 422 20 12
Fax 032 422 20 45
direction@liguepj.ch

Luzern-Zug/
Nidwalden/Obwalden
Lungenliga Luzern -Zug
Schachenstrasse 9
6030 Ebikon
Tel. 041 429 31 10
Fax 041 429 31 11
info@lungenliga-lu-zg.ch

Neuchâtel
Ligue pulmonaire neuchâteloise
8, avenue du Peyrou
2000 Neuchâtel
Tél. 032 723 08 68
Fax 032 723 08 69
ligue.pulmonaire@ne.ch

St. Gallen/
Appenzell AI/Appenzell AR
Lungenliga St. Gallen
Florastrasse 4
Postfach
9006 St. Gallen
Tel. 071 228 47 47
Fax 071 228 47 48
info@lungenliga-sg.ch

Schaffhausen
Lungenliga Schaffhausen
Grabenstrasse 7
8200 Schaffhausen
Tel. 052 625 28 03
Fax 052 625 37 74
info@lungenliga-sh.ch

Schwyz
Lungenliga Schwyz
Bahnhofstrasse 16
Postfach 101
8808 Pfäffikon SZ
Tel. 055 410 55 52
Fax 055 410 55 92
pfaeffikon@lungenligaschwyz.ch

Solothurn
Lungenliga Solothurn
Dornacherstrasse 33
4500 Solothurn
Tel. 032 628 68 28
Fax 032 628 68 38
info@lungenliga-so.ch

Thurgau
Lungenliga Thurgau
Bahnhofstrasse 15
Postfach 251
8570 Weinfelden
Tel. 071 626 98 98
Fax 071 626 98 99
info@lungenliga-tg.ch

Ticino
Lega polmonare ticinese
Via alla Campagna 9
6904 Lugano
Tel. 091 973 22 80
Fax 091 973 22 89
legapolm@bluewin.ch

Uri
Lungenliga Uri
Seedorferstrasse 19
6460 Altdorf
Tel. 041 870 15 72
Fax 041 870 18 58
lungenliga.uri@bluewin.ch

Valais
Ligue pulmonaire valaisanne
Rue des Condémines 14
Case postale 888
1951 Sion
Tel. 027 329 04 29
Fax 027 329 04 30
info@lvpp.ch

Vaud
Ligue pulmonaire vaudoise
Avenue de Provence 4
1007 Lausanne
Tel. 021 623 37 47
Fax 021 623 37 10
info@lpvd.ch

Zürich
Lungenliga Zürich
Wilfriedstrasse 7
Postfach
8032 Zürich
Tel. 044 268 20 00
Fax 044 268 20 20
info@lungenliga-zh.ch

Fürstentum Liechtenstein
Amt für Gesundheit
Aeulestrasse 51
Postfach 684
FL-9490 Vaduz
Tel. 00423 236 73 34
Fax 00423 236 73 39

SWISS LUNG ASSOCIATION